REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PRRENJAS

Kalendari i aktiviteteve të organizuar në sektorin e kulturës pranë Bashkisë Prrenjas

Nr.	Aktivitetet	Specifikimet
1	7-8 Marsi. Festat e Mesuesëve dhe Nënës	Nuk u zhvillua aktivitet, për arsye të mosmiratimit të buxhetit vjetor në kohën e duhur.
2	5-Maj Dita e dëshmorëve	Me rastin e ditës së dëshmorëve u zhvilluan disa vizita në disa lapidarë të zonës duke vendos kurora dhe mbajten e fjalimeve në nder të veteranëve të rënë përgjatë Luftëssë II Botërore kundër Nazi-Fashizmit.
3	1-Qershori Dita e fëmijëve	Në ditën e fëmijëve u organizua një koncert në qendër të qytetit me pjesëmarrjen e "artistave" të vegjël të shkollave të komunitetit si dhe kopshtit të qytetit. U përgatit qendra dhe skena tërësisht me një ambjent argëtues dhe festiv si dhe u shpërndanë disa dhuratasi: balona, ngjyra, maska, tullumbace etj.
4	24-Korrik Festa e Bërzeshtës	Në monumentin e kulturës "Rrapi i Bërzeshtës" si një traditë tashmë, u organizua mbajtja e fjalimit nga Kryetari I Bashkisë Prrenjas dhe Kryetari I veteranëve të Rrethit Librazhd si dhe disa veteran, në nder të të rënëve dëshmorë të njërës brigade më të fuqishme të Rrethit Librazhd e më gjërë.

		Më pas u mbajt një koncert festiv me këngëtarët e zonës duke e krijuar një ditë feste.
5	22-Tetor Stop trafikimi i fëmijëve	Në kuadër të bashkëpunimit me Sektorin e Shërbimeve Sociale, u organizua dhe u mbajt një aktivitet në Qendrën Kulturore Prrenjas për të përcjellë mesazhe të ndryshme për të parandaluar trafikimin e fëmijëve, me temë "Stop Trafikimi" nëpërmjet ekspozitës së punimeve për muajin antitrafik.
6	20 Nëntor. DitaNdërkombëtare e Të Drejtave Të Fëmijëve	Në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimeve Sociale u organizua një aktivitet në Qendrën Kulturore Prrenjas, me pjesëmarrjen e nxënësve të dy shkollave të komunitetit, atë të 9- vjeçares Katjel dhe 9- vjeçare Rrajcë- Fushë. Aktiviteti përmbante role profesionesh, vjersha, ekspozitë, këngë si dhe mesazhe tërësisht në kuadër me në qëndër fëmijët dhe të drejtat e tyre.
7	28-29 Nëntori. Festa e Flamurit dhe 75-vjetori i çlirimit të Shqipërisë	Në ditën e flamuritdhe 75-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë u dekorua qyteti me ngjyra e flamujt kuq e zi si dhe mbishkrime dhe një vëmëndje më e gjërë në 75- vjetorin e çlirimit të Shqipërisë. U përgatit edhe koncert me rastin e festive të nëntorit por përshkak të tërmetit shkatërrues që goditi vëndin u anullua dhe nuk mbajt.
8	Festat e fund vitit. Krishtlindjet dhe Vitin e Ri.	Dekorimi i qytetit, vendosja e pemës dhe dritat në qendër të qytetit si dhe një aktivitet, koncert festiv.